

DEKLARATË PËR CILËSINË E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË IKTK-së, VITI 2022

Unë, i nënshkruari Eugen Kallfani, në cilësinë e nëpunësit Autorizues dhe të Koordinatorit të Riskut në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo financiarë të njësisë, si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i Njësisë, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë, në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar, sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të IKTK-së, gjatë vitit raportues 2022, nëpërmjet të gjithë komponentëve të tij konform legjislacionit në fuqi dhe parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar, sistem i cili mbështet arritjen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të IKTK-së, si dhe garanton se fondet publike shpenzohen për të përmbushur objektivat e përcaktuara.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në IKTK-së ka funksionuar për vitin 2022, si dhe përkon me udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklarate pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

Ky raport është përcjellë tek Grupi i Menaxhimit Strategjik i kryesuar nga Titullari i IKTK-së.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Eugen Kallfani

RAPORT

PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE PËR VITIN 2022

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Raport është përgatitur në zbatim të Neni-t 18 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, dhe jep informacion mbi cilësinë dhe kushtet e Kontrollit të Brendshëm si dhe evidencë mbi gjetjet kryesore mbi MFK-në, në sistemin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Rezultatet janë gjeneruar nga informacioni i marrë nga raportet periodike dhe Analizat Vjetore të punës nga sektorët pranë IKTK-së, mbi ecurinë e veprimtarisë së tyre, objektivate dhe operacioneve përkatëse, për vitin 2022 si dhe evidencave financiare të shpenzimeve dhe të të ardhurave mujore, katër mujore dhe vjetore. Pyetësi i Vetëvlerësimit është plotësuar dhe do të përcillet në mënyrë elektronike dhe shkresore në Ministrinë e Kulturës (MK).

Në kuadër të hartimit të raportit vjetor të sistemit të kontrollit të brendshëm në IKTK, informacioni i siguruar nga strukturat e sipërcituara është përpunuar dhe hartuar konform strukturës së raportit të përcaktuar në Udhëzimin Nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”.

Konkretisht më poshtë analizohet gjendja e komponentëve të veçantë të Sistemit të MFK-së, për sistemin e IKTK-së për vitin 2022, si më poshtë vijon:

II. PARIMET BAZË TË FUNKSIONIMIT TË INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE.

Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, funksionon në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, “Statuti i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 342, datë 22.09.2020 dhe “Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 344, datë 22.09.2020 dhe në mbështetje të VKM nr. 208 datë 10.4.2019 për “Përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ent publik me statusin e personit juridik që financohet nga buxheti i shtetit.

III. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Detyra themelore e IKTK-së, është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit. Misioni i IKTK-së është të marr të gjitha masat që të siguroj gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij.

IKTK-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë vijon:

- a) të trashëgimisë kulturore materiale;
- b) të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor;
- c) të pasurisë e peizazhit kulturor.

Në zbatim të VKM-së Nr. 364 datë 29.05.2019 për *"Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore"*, IKTK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

- a) monitoron dhe koordinon DRTK-të, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre;
- b) konstaton verifikimin ose jo, të interesit kulturor për pasuritë e paluajtshme sipas procedurave përkatëse në ligjin për trashëgiminë kulturore;
- c) nëpërmjet sekretarisë teknike kryen verifikimet e natyrës teknike dhe siguron nga kërkuesit informacione të tjera shtesë në funksion të vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, lidhur me kërkesat për ndërhyrje;
- ç) vendos pezullimin e menjëhershëm të ndërhyrjeve kur me propozim të institucioneve të specializuara ose kryesisht konstaton kryerjen e punimeve në kundërshtim me ligjin;
- d) monitoron ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara;
- dh) kryen formimin e vazhdueshëm të personave të pajisur me licenca në fushën e projektimit e të zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, veprimtarisë arkeologjike;
- e) kryen studime për shtrirjen e zonës së mbrojtur për pasuritë kulturore të paluajtshme ose grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme;
- ë) vendos masat e mbrojtjes indirekte, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- f) propozon procedurën për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike;
- g) koordinon planet e zhvillimit, të projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore të NJAKPA-ve;

gj) ndjek gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj;

h) nëpërmjet punonjësit të autorizuar pezullon punimet që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në rastin e zbulimeve të rëndësishme;

i) regjistron njoftimet për gjetjet rastësore detare dhe nëntokësore;

j) studion dhe përcakton kufijtë e zonave të mbrojtura të pasurive kulturore;

k) konsulton ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rrjetëzim për vlerat kulturore të paluajtshme;

l) së bashku me IKRTK-në harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore;

ll) kryesisht ose me propozim të institucioneve të specializuara të njësive të qeverisjes qendrore ose të vetëqeverisjes vendore fillon procedurën e vlerësimit, duke verifikuar ekzistencën e interesit të veçantë publik për pasuritë e peizazhit kulturor për pasuritë e paluajtshme dhe për zonat për të cilat është marrë iniciativa;

m) lëshon lejet e peizazhit kulturor pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, si dhe i sugjeron Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale vendosjen e distancave, masave/hapësirave dhe variante të projektit në fazë ekzekutimi të nevojshme për ruajtjen e vlerave të peizazhit;

n) përgatit dhe realizon në mënyrë periodike botime të ndryshme shkencore, albume dhe udhërrëfytes;

nj) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara;

o) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

p) çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

IV. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT

IV.1.Përmirësimi i kuadrit ligjor

- a) Të angazhohet në hartimin e projekt akteve në bazë të Planit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve (PPAP), për vitin 2022 nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës; (Të gjithë sektorët).
- b) Hartimi i propozimit për tarifat e shërbimeve të ofruara nga IKTK dhe paraqitja e tyre pranë Ministrisë së Kulturës, për përfshirjen në Urdhrin e Përbashkët të saj me Ministrinë e Financave; (Të gjithë sektorët)
- c) Hartimi i udhëzuesit për menaxhimin dhe administrimin e tarifave të shërbimit të IKTK; (Të gjithë sektorët)
- d) Hartimi i Strategjisë së Riskut 2022-2024 për IKTK; (Të gjithë sektorët)
- e) Përmirësimi i kuadrit ligjor me akte ligjore dhe nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (DMK + DSHA):
 - ✓ VKM për deklarimin e interesit kulturor;

- ✓ VKM e re “Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP);”
- ✓ VKM e rishikuar “Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP);
- ✓ VKM për zonifikimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Beratit, Vlorës dhe Sarandës dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

IV.2.Partneritete dhe Marrëveshje bashkëpunimi (IKTK)

- a) Rritja e fondeve të përthithura nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet realizimit të suksesshëm të partneriteteve të lidhura për projektet me fonde IPA;
- b) Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet IKTK-së dhe Institucioneve të arsimit të lartë, si dhe organizmave që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

IV.3.Programe shtetërore dhe ndërkombëtare në trashëgimi kulturore

- a) Bashkëpunim i drejtpërdrejtë me INRAP (Institut National de Recherches Archéologiques Préventives), Francë dhe Ministrinë e Kulturës Francë për organizimin e programit/aktivitetit “DITËT EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË” në datat 17-18-19 qershor 2022, ku IKTK ishte në rolin e koordinatorit për Shqipërinë;(DSHA)
- b) Pjesëmarrje me temë në konferencën Ndërkombëtare të EAC (European Archaeological Council) në takimin vjetor të 23-të me temë “Archaeology and the Natural Environment”, në datat 24-25 mars 2022, në Vienë, Austri; (DSHA)
- c) Pjesëmarrje me temë në konferencën Ndërkombëtare të EAA (European Association for Archaeologists) në takimin vjetor të 28-të me temë “REINTEGRATION”, në datat 31 Gusht 2022 - 3 Shtator 2022 , në Budapest, Hungari;(DSHA)

IV.4.Marrëdhënie me UNESCO-n në kuadër të mbrojtjes së Pasurive Botërore në Shqipëri dhe në kuadër të zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore

- a) Realizimi i draftit final të Planit për Menaxhimin e Integruar për qendrat historike Berat dhe Gjirokastër. (IKTK)

IV.5.Aktiviteti i IKTK-së në përputhje me Planin e punës 2022

- a) Pasurimi i listës së pasurive kulturore nëpërmjet një procesi studimi te thelluar kërkimor-shkencor.
- b) Rritja e cilësisë dhe sasisë së hartimit të projekteve të restaurimit për objekte pasuri kulturore në territorin e Shqipërisë.
- c) Rritja e cilësisë së kryerjes së procesit të mbikëqyrjes për objektet pasuri kulturore në zbatim të akteve ligjore në fuqi.
- d) Rritja përafërsisht në masën 10% të shërbimeve arkeologjike në terren (gërmime/sondazhe, dokumentime arkeologjike, vëzhgime arkeologjike, verifikime në terren dhe gjetje rastësore), me synim përmbushjen e veprimtarisë dhe misionit, si dhe rritjen e burimeve të financimit të DSHA-IKTK.

- e) Ndjekja dhe zbatimi në kohë i marrëveshjeve tre palëshe për shërbime monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve si dhe mbikëqyrjes arkeologjike gjatë realizimit të sondazheve/gërmimeve arkeologjike, në përgjigje të kërkesave dhe ritmeve të zhvillimit të projekteve nga subjektet aplikues.

IV.6. Monitorime arkeologjike të subjekteve private të licencuar në arkeologji- 24 në total

IV.7. Sekretaria Teknike e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale – KKTKM

- a) Përforcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore me qëllim menaxhimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Sekretaria Teknike e IKTK-së;
- b) Të mundësojë publikimin brenda një afati sa më të shkurtër të mundshëm të Vendimeve të KT-së, KKTKM-së, Regjistrave Publikë si dhe njoftimeve të ndryshme në faqen web të IKTK-së;

IV.8. Programe për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe Kërkimi Shkencor

- a) Mundësia e financimit të kurseve të trajnimit / Atelieve të Restaurimit, të propozuara nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore, nëpërmjet përmirësimit të projekt propozimeve dhe rritjes së numrit të kërkesave për financim.

IV.9. Botime dhe Promovime

- a) Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike “Monumentet” Nr.61 organ i IKTK-së, nëpërmjet rritjes së numrit të artikujve shkencor të hartuar nga stafi i IKTK-së (Për këtë vit do të hartohen 4 artikuj shkencorë nga IKTK: 1 SQHATP +1 SVA+ 1 SAAM+1 QRKREJ);
- b) Të realizojë numri i parë i “Revista Arkeologjike”, botim shkencor që do të shërbejë për të publikuar punën kërkimore të Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK, si dhe artikuj të tjerë nga institucione shtetërore të specializuara apo individë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë arkeologjike.

IV.10. “Digjitalizimi i arkivit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokollit për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence”

- a) Realizimin e skanimit të kartotekës së Arkivit Teknik të IKTK-së, në masën 80 %; (Arkiva Teknike)

IKTK-së ka krijuar dhe monitoruar një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit mbështetur në legjislacionin në fuqi, dispozitave të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 ”Mbi menaxhimin financiar e kontrollin” i ndryshuar si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasitet.

Ky sistem është një proces, i cili ofron dhe jep garanci të arsyeshme për arritjen e objektivave nëpërmjet:

- ✓ Efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve

- ✓ Pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi
- ✓ Besueshmërisë në raportimet financiare e menaxheriale
- ✓ Mbrojtjes së aktiviteteve

Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në njësinë organizative të institucionit përfshin tërësinë e masave për menaxhimin e kontrollit e të gjithë të ardhurave të krijuara në institucion, shpenzimet si dhe aktivet e krijuara.

Garantimi i këtij procesi dhe respektimi i parimeve bazë të tij arrihet nëpërmjet krijimit dhe kombinimit të kontrollit të të gjithë komponentëve të sistemit, përkatësisht:

1. Mjedisi i kontrollit
2. Menaxhimi i riskut
3. Aktivitetet e kontrollit
4. Informacioni e komunikimi
5. Monitorimi

1. MJEDISI I KONTROLLIT

a) Vendosja e objektivave

Në njësinë tonë organizative është krijuar një mjedis i përshtatshëm kontrolli i cili shërben si instrument për menaxhimin e mirë të fondeve publike si dhe për të gjithë komponentët e tjerë të menaxhimit financiar e kontrollit.

Për vitin 2022, siç është deklaruar në pyetësorin e vetëvlerësimit dhe sa më sipër, është vepruar në përputhje me misionin e përcaktuar, programet, objektivat, produktet dhe aktivitetet në përputhje me programet e Ministrisë së Kulturës, si dhe plan-veprimet për realizimin e tyre të përfshira dhe të njohura për gjithë punonjësit.

b) Etika personale e profesionale

Etika personale dhe profesionale është rregulluar në zbatim të Ligjit Nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjin Nr.119 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e Informimit”, Kodi Civil, Kodi i Procedurave Administrative, “Statuti i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 342, datë 22.09.2020 dhe “Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 344, datë 22.09.2020, “Kodi i Etikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshme me Nr.737 Prot., datë 15.04.2020 ku janë parashikuar standardet e sjelljes në vendin e punës, respektimi e zbatimi i detyrave, refuzimin dhe kundërshtimin e urdhrave e detyrave që bien ndesh me ligjin dhe normat morale e profesionale, informimin për parregullsitë, denoncimin për çdo veprim të shfaqjeve korruptive në kryerjen e detyrave, ndjekja e procedurave të ankimit, profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrës konform dispozitave ligjore e nënligjore, marrëdhëniet me eprorët, sjelljen ndaj publikut, përgjegjësitë në rast të shkeljeve të rregullave të etikës.

Këto norma dhe rregulla ndihmojnë në implementimin e kërkesave të parimeve më të rëndësishme të etikës siç janë ligjshmëria, paanshmëria dhe mungesa e konfliktit të interesave, ku janë përcaktuar

rregullat, mjetet, mënyrat dhe procedurat për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave si dhe sanksionet, për shkeljen e kësaj rregulloreje.

c) Stili Menaxherial

Për sa i përket stilit menaxherial është ndjekur praktika e zhvillimit të takimeve të rregullta të menaxhimit për diskutimin e çështjeve themelore të menaxhimit të njësisë publike ku ata bëjnë pjesë, e cila është parashikuar dhe në Statutin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, miratuar me “Statutin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 342, datë 22.09.2020 dhe “Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 344, datë 22.09.2020.

d) Ndarja e detyrave

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” dhe krijimit të IKTK-së u ndryshua struktura dhe organika e institucionit.

Një ndër elementet thelbësorë përbërës të stilit menaxherial është dhe delegimi i detyrave. IKTK është strukturuar në 2 Drejtori: Drejtoria e Monumenteve të Kulturës e përbërë nga 6 (gjashtë) sektorë, Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik e përbërë nga 2 (dy) Sektorë, si dhe 4 Sektorë të tjerë, të cilët varen drejtpërdrejt nga Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve delegojnë detyrat tek specialistët përkatës, referuar organikës së miratuar me Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” dhe krijimit të IKTK-së u ndryshua struktura dhe organika e institucionit. Detyrat janë paraqitur në rregulloren e brendshme sipas hierarkisë së përcaktuar në strukturë.

Gjithashtu, ekzistojnë delegime të detyrave e përgjegjësi të nëpunësit autorizues, sipas “Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Brendshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 344, datë 22.09.2020, për të respektuar afatet në kohën e delegimit, mënyrën e raportimit në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative dhe Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Nëpunësi autorizues e zbatues është caktuar sipas strukturave përkatëse në zbatim të Ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Në rolin e nëpunësit autorizues është Z. Eugen Kallfani, Drejtor i Përgjithshëm i Institucionit, si menaxheri më i lartë ekzekutiv emëruar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës Nr.749, datë 02.11.2022 “Për emërimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”

Në cilësinë e nëpunësit zbatues është Znj. Afrida Domnori, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në varësi direktet nga nëpunësi autorizues, e cila mbulon dhe menaxhon financat publike. Ky sektor mbulon dhe menaxhon buxhetin, politikën e burimeve njerëzore të gjithë institucionit, si dhe të gjithë organizimin me shërbimet mbështetëse të përgjithshme të Institucionit.

Veprimtaria e Shërbimeve Mbështetëse, Burimeve Njerëzore dhe Veprimtaria që mbulon Financat janë të përfshira në një sektor të vetëm.

e) Struktura organizative

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” është krijuar IKTK.

Aktualisht në strukturën e miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” janë 58 punonjës.

Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga pozicionet administrative, si vijon:

a) Drejtori i Përgjithshëm	1
b) Sektori i Sekretarisë Teknike	1+2
c) Sektori i Arkivës Teknike	1+2
d) Drejtoria e Monumenteve të Kulturës	1
i. Sektori i Veprave të Artit	1+6
ii. Sektori i Arkitekturës Antiko-Mesjetare	1+7
iii. Sektori i Qendrave Historike, Arkitektura e Traditës dhe Peizazhit	1+7
iv. Sektori i Qendrës Rajonale të Konservimit dhe Restaurimit për Evropën Juglindore	1+2
e) Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik	1
i. Sektori i Shpëtimit Arkeologjik Nëntokësor dhe Nënutor	1+2
ii. Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Arkeologjike Nëntokësore dhe Nënutor	1+2
f) Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	1+2+11
g) Sektori i Platformës Digjitale për Trashëgiminë Kulturore	1+2

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM-së me Nr. 208 datë 10.4.2019 për “Përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, funksionon Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, sekretar i të cilit është Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së.

Pranë KKTKM-së funksionojnë këto struktura administrative:

- a) këshilli teknik;
- b) sporteli unik;
- c) sekretaria teknike.

f) Masa e veprime

Në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, IKTK-ja është pjesë e procesit të hartimit, përditësimit, konsultimit për aktet nënligjore të nevojshme në fushën e trashëgimisë kulturore. IKTK-ja, në bazë të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve (PPAP), nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës (MK) dhe në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK), gjatë vitit 2022, kanë propozuar hartimin/rishikimin e akteve nënligjore.

g) Akte nënligjore të miratuara

1. Vendim Nr. 420, datë 15.6.2022, “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”.

h) Akte nënligjore në proces miratimi

1. Projekt vendim: “Për miratimin e masave ruajtëse të trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”.
2. Projekt vendim: “Për përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin”.
3. Projekt vendim: “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të bazës së të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në RSH”.
4. Projekt vendim: “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së “Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim” (QRKR).
5. Projekt Udhëzim i përbashkët MK dhe MF për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKTK.
6. Projekt Udhëzim: “Për termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme”.
7. Projekt Udhëzim i përbashkët për: “Parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin”.
8. Projekt Udhëzim: “Për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshme”.
9. Projekt Udhëzim: “Për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jo materiale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së”.
10. Projekt Udhëzim: “Për kriteret e përpilimit të listave të pasurive të paluajtshme në pronë shtetërore, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruese dhe dërgimin e tyre për verifikim”.
11. Projekt vendim: për zonifikimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Beratit, Vlorës dhe Sarandës dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.
12. Projekt vendim: në lidhje me zonën arkeologjike nënujore të bregdetit të qytetit të Durrësit, në bashkëpunim me IA dhe QMD.
13. Projekt vendim: për zonën Arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës dhe zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, Kalasë së Lëkurësit dhe Manastirit të 40 Shenjtorëve.

i) Procesi i përafrimit të legjislacionit në kuadër të integritetit evropian

Gjatë vitit 2022 në kuadër të Grupit Ndërmintor për Integritetin Evropian për Kapitullin e tretë, ku IKTK-ja përfaqësohet me një anëtar është dhënë kontribut për hartimin e dokumentit të mangësive ligjore dhe institucionale LGA dhe IAGA, si dhe është dhënë kontribut për hartimin e PKIE 2021-2023 Në zbatim të Ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe Vendimit Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimi e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale” gjatë vitit 2022 janë miratuar në Këshillin Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

NR	RREGULLORE TË MIRATUARA OSE TERMA REFERENCE
1	Miratim i termave të referencës me objekt mbi “Hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar (PMI) për “qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë” - pasuri botërore në seri.
2	Miratim i termave të referencës për “PROJEKTIMI, RESTAURIMI DHE MUZEALIZIMI I ISH-BANESËS SË TOPTANASVE/ LIBOHOVITËT”, Tiranë
3	Miratim në parim i termave të referencës për Planin e Menaxhimit të ish-Burgut të Spacit, MK, Kat.I, nga CHwB
4	Miratim në parim i Planit të Menaxhimit të Integruar, Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave nga U.P.Tiranës
5	Miratim i Termave të Referencës “Mbi Hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar (PMI) Për “Qendrat Historike Berat Dhe Gjirokastrë” - Pasuri Botërore Në Seri”, hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK)
6	Miratimin e Termave të referencës “Gjirokastra Castel Sustainable Management and tourism Valorization”
7	Miratimin e termave të referencës për projektin “Termet e Referencës për hartimin e planeve të menaxhimit për Muzeun arkeologjik, Hamamin, Kullen Veneciane”, brenda Z.A.“A”, Durres me aplikues Liri Shehaj dhe zhvillues UNOPS.
8	Miratim i Termave të Referencës për “Restaurimi, Rikonceptimi dhe Muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar”, MK, Kat.II, Tirtane me aplikues UNOPS
NR	DEKLARIM I INTERESIT KULTUROR
1	-
NR.	MUNGESË E INTERESIT KULTUROR
1	Miratim i kërkesës së Z. Adem Alushi, për mungesën e interesit kulturor për monument kulturor, Kat.II-te, për objektin “Banese tip vile, 1 kat, Rr.”Dervish Hekali” (II-209)
2	Mosmiratim i kërkesës së Z. Hekuran Caka, për rishikimin e statusit Monument kulturor, kat.II, për objektin “Banese tip vile, 1 kat, Rr.”Qemal Stafa” (II-212), Tiranë
3	Miratim në parim i kërkesës së Z. Hekuran Caka, për deklarin e mungesës së interesit kulturor për objektin “Banese tip vile, 1 kat, Rr.”Qemal Stafa” (II-212), Tiranë

j) Këshilli Teknik

Në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM-së me Nr. 208 datë 10.4.2019 për “Përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, funksionin edhe Këshilli Teknik.

Këshilli teknik është organ kolegjal seleksionues, vlerësues e vendimmarrës, që ka në përbërje 7 anëtarë, të cilët janë pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së.

Këshilli teknik kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura pranë KKTKM-së. Vendimi ose relacioni që i dërgohet KKTKM-së nga ana e Këshillit teknik firmoset nga kryetari.

Këshilli teknik ka kompetencë të miratojë kërkesa që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtje të pasurive kulturore, sipas listës së ndërhyrjeve të miratuara nga KKTKM-ja.

Për çështje të tjera, që, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 janë kompetencë e KKTKM-së, këshilli teknik, pasi shqyrton përputhshmërinë e kërkesave të paraqitura, miraton relacionin përkatës, të hartuar nga sekretaria teknike, dhe ia përcjell për vendim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

k) Sporteli Unik

Sporteli unik është pjesë e strukturës administrative pranë IKTK-së, ku depozitohen të gjitha kërkesat për aplikim, për të cilat është kompetente KKTKM-ja. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

l) Sekretaria Teknike

Sekretaria teknike është pjesë e strukturës administrative të IKTK-së, në funksion të KKTKM-së, e cila administron kërkesat dhe përgatit dokumentacionin për vendimmarrje të KKTKM-së. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

m) Redaksitë e Revistës “Monumentet” dhe “Revistës Arkeologjike”

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Statutit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës me Nr. 344, datë 22.09.2020 “Për miratimin e Rregullores dhe Funksionimin e Brendshëm të Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”, lindi nevoja për rikrijimin e Redaksisë për botimin periodik dhe shkencor të “Revistës Monumentet” si dhe botime të tjera, albume, guida etj. Gjatë vitit 2022 janë botuar revista “Monumente” nr. 61 dhe “Revista Arkeologjike” nr. 1.

n) Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM)

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

KKTKJ-ja përbëhet nga 15 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson, dhe 14 anëtarë që emërohen prej tij.

Anëtarë të KKTKM-së janë:

- a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) përfaqësues të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) 3;
- c) përfaqësues nga drejtoritë përgjegjëse për çështjet e trashëgimisë kulturore në ministrinë përgjegjëse për kulturën 2;

ç) përfaqësues të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) 1;

d) jurist i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore 1;

dh) personalitete të fushës së arkeologjisë 2;

e) përfaqësues nga Universiteti i Tiranës 2;

ë) personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore materiale, të cilët kanë një eksperiencë të pasur profesionale ose akademike në disiplinat e arkeologjisë, restaurimit dhe konservimit të pasurive kulturore materiale, trashëgimisë arkitektonike apo menaxhimit të trashëgimisë kulturore materiale 3. Anëtarët e KKTKM-së përmbushin detyrën e përgjegjësitë e tyre dhe deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar

Gjatë vitit 2022, IKTK në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës ka bashkërenduar dhe vijon punën në disa programe të rëndësishme, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të projekteve:

I. POLITIKAT DHE PRAKTIKA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

1. REKRUTIMI

Procedurat e rekrutimit të punonjësve të institucionit mbështeten në dispozitat e Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.2003 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të “Rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 344, datë 22.09.2020.

Procesi i rekrutimit ndjek dhe zbaton procedurat e emërimit nëpërmjet: shpalljeve të vendeve vakante sipas VKM-së Nr. 176, datë 29.3.2006 “Për Botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike”, dhe faqen zyrtare Web të IKTK, si dhe lëvizjet e brendshme brenda IKTK-së sipas sistemit të karrierës si dhe zëvendësimet e përkohshëm të rasteve kryesisht zëvendësim leje lindje.

Këto zëvendësime të përkohshme janë realizuar me qëllim mbarëvajtjen normale të punës në institucion.

Në zbatim të “Rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës, me Nr. 344, datë 22.09.2020,

Procedurat e Rekrutimit ndjekin këto hapa:

- 1) Punësimi në IKTK bëhet me kontratë individuale pune me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar, sipas nevojave administrativo-institucionale si dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës;
- 2) Punëdhënësi emëron në mënyrë të drejtpërdrejte punëmarrësin;
- 3) Punëdhënësi për të emëruar punëmarrësin mund të përdorë shërbimet e zyrave shtetërore të punësimit ose të agjencive private të punësimit.
- 4) Punësimi mund të kryhet me përzgjedhje sipas procedurës së shpalljes publike:
 - a) Procedura e konkurrimit zhvillohet me nismën e institucionit kur konstatohen pozicione të lira pune në strukturë;

- b) Pozicionet e lira të punës mund të publikohen me anë të njoftimi në internet, në faqen zyrtare të IKTK-së/Buletin e Njoftimeve Publike, si dhe i komunikohen Ministrisë së Kulturës për publikimin e vendeve vakante në faqen zyrtare ëëë.kultura.gov.al;
- c) Njoftimi për vend të lirë pune shoqërohet me: emërtimin e pozicionit të punës, dokumentacionin ligjor që duhet të paraqesin kandidatët, kriteret dhe specifikat përkatëse në varësi të pozicionit të punës, si dhe ditën dhe orën përfundimtare të dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës;
- d) Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacioni i paraqitur mund të kryhet nga një komision i përbërë nga jo më pak se tre anëtarë, në përbërje të të cilit mund të jenë: Drejtori i IKTK-së, 1 (një) përfaqësues i sektorit për të cilin aplikohet, 1 (një) përfaqësues nga sektori përgjegjës për burimet njerëzore dhe sipas rastit 1 (një) përfaqësues nga Ministria dhe/ose 1 (një) ekspert i fushës;
- e) Përbërja e komisionit ngrihet me Urdhër të titullarit të institucionit;
- f) Shpallja e fituesit mund të publikohet me anë të një njoftimi në internet, në faqen zyrtare të IKTK-së dhe/ose të Ministrisë së Kulturës.

Gjatë vitit 2022 ka patur shumë vende vakante, që edhe pse janë shpallur konkurset, nuk kanë marrë pjesë kandidatë me formimin e kërkuar në thirrje (inxhinierë ndërtimi, arkitektë) Në planin afatshkurtër vëmendja e burimeve njerëzore u përqendrua në:

- a) Rritjen e performances;
- b) Nxitjen dhe motivimin e punonjësve.

2. TRAJNIMET DHE PJESËMARRJE NË KONFERENCA DHE WORKSHOP

Në lidhje me trajnimet e zhvilluar dhe workshopeve të organizuara për rritjen e kapaciteteve njerëzore, duke mos patur një sektor të posaçëm për të realizuar trajnime, jemi mbështetur në mundësitë e ofruara nga jashtë IKTK-së, si dhe bashkëpunimeve të vazhdueshme me aktor të tjerë.

- a) Hartim i draft programit për organizimin e "DITËVE EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË" dhe organizimi i eventeve në kuadër të DTA, të zhvilluara në Durrës, Parkun Arkeologjik Butrint dhe Parkun Arkeologjik Apoloni.
- b) Pjesëmarrje në trajnim nr.1 në kuadër të GNPIE-së, për Kapitullin 3 të Acquis.
- c) Workshop mbi Përqasjet Novatore të Shkencës dhe Teknologjisë së Përsheptuesit për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Trashëgimisë Selisë së IAEA, Vienna, Austria.
- d) Trajnim ndërkombëtar UNESCO, on-line dhe në prezencë "WH-Interp II course", pjesëmarrëse nga IKTK - Përgjegjës Sektori - SAAM - Joli Mitrojorgji.
- e) EAC - European Archaeological Council - Takimi vjetor i 23-të me temë "23-rd Heritage Management Symposium", në Vienë.
- f) Organizimi i workshop për PMI Berat - Gjirokastrë (6-8 Shtator 2022).
- g) Workshop rajonal nga 17-21 tetor në rajonin e Ohrit në tetor, si pjesë e projektit “Ndërtimi i një të ardhmeje elastike ndaj klimës: Zhvillimi i kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendet e përzgjedhura të UNESCO-s të Evropës Juglindore”. Realizuar 3- sesione on line, në proces hartimi i prezantimit, Rast Studimor QH Berat - Gjirokastrë, pasuri botërore.
- h) Trajnim për Interpretimin e Siteve të Trashëgimisë Kulturore nga UNESCO - Lubjana 22 Shtator.

- i) Workshop me rastin e Ditëve të Trashëgimisë Kulturore "Shkenca dhe Teknologjia në mbështetje të Trashëgimisë Kulturore" organizuar nga IKTK (Sektori i Veprave të Artit) me pjesëmarrjen e specialistëve të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), Prof. Fatos Ylli dhe Dr. Marta Anghelone, përfaqësuese e International Atomic Energy Agency (IAEA) Vienë, Austria.
- j) Trajnim në kuadër të përfshirjes në sistemin AFMIS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Financave Publike), i cili realizon marrëdhëniet financiare të buxhetit në formë digjitale, realizuar nga Ministria e Financave, Dega e Thesarit.(5-10 Nëntor 2022)
- k) Workshop - Ministria e Mbrojtjes, mbi parandalimin e hershëm rajonal të Ballkanit, organizuar nga AKMC.
- l) Misioni i Përbashkët Këshillimor i WHC ICOMOS në zonën e trashëgimisë botërore të Butrintit (26 - 29 Tetor 2022). Përgatitje dhe shoqërim i misionit të përbashkët të monitorimit WHC-ICOMOS.

3. VLERËSIMI

Mbështetur në “Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Kulturës është përcaktuar vlerësimi vjetor individual i të gjithë punonjësve sipas formularit të vlerësimit.

4. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE

Forcimi i kapaciteteve administrative është një sfidë e vazhdueshme e institucioneve publike në procesin e integritimit evropian. Nga sa më sipër, IKTK-së i duhet të ballafaqohet me ndryshime të shumta.

5. MASA E VEPRIME

Mendojmë se si institucion gjithnjë e në rritje si dhe në kuadër të përafrimit të legjislacioneve me ato të BE, kërkojmë forcim të kapaciteteve administrative, dhe të bazave ligjore me qëllim realizimin e objektivave.

6. PROBLEMATIKA DHE MOSREALIZIME.

Probleme administrativo – juridike, të hasura gjatë administrimit të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2022 janë:

- a) **Mungesat në aktet ligjore në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”,** ka penguar vijimësinë normale të zhvillimit të punës së institucionit sipas funksionit të tij si p.sh.:
 - ✓ mungesa e V.K.M-së për procedurën e deklarimit të interesit kulturor;
 - ✓ mungesa e bazës ligjore për tarifat përkatëse për aplikimet e projekteve në sistemin e-leje, për monitorimin arkeologjik, mbikëqyrje, kolaudim etj.;
 - ✓ mungesa e bazës ligjore për tarifat përkatëse lidhur me aplikimet në Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik lidhur me shërbimin kopje dokumentacioni nga arkiva teknike dhe Biblioteka e IKTK, si dhe për aplikimet e tjera për vënin në dispozicion të materialeve arkivore të Arkivit Teknik.

b) **Mungesa e mbrojtjes nga sulmet kibernetike** ka ndikuar në mosrealizimin e disa objektivave, si të hartim-zbatimit të projekteve, të skanimit të fondit të kartotekës në masën 80%, me 10% më pak nga parashikimi, bllokimit të disa pajisjeve kompjuterike për shkak se nuk përmbanin kushtet e vendosjes së sigurisë së përcaktuar tashmë nga AKSHI.

c) **Mungesa e fondeve për:**

- ✓ Realizimin e projekteve të hartuara, të cilat janë marrë parasysh dhe janë paraqitur si kërkesa shtesë gjatë hartimit të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2022 – 2024;
- ✓ Pasuritë kulturore të cilat rrezikohen nga kushte të jashtme atmosferike dhe ato në listën e Riskut.
- ✓ Realizimin e projekt propozimeve të IKTK-së për kurse trajnimi në kuadër të forcimit të kapaciteteve profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore;
- ✓ Mungesa e fondeve dhe mosrealizimi i mirëmbajtjes së sistemeve WebGis ka qenë problematika kryesore që ka hasur sektori në punën e tij. Kjo ka sjellë mos realizimin e shërbimit, kryesisht për sistemin WebGis Monumentet, i cili ka qenë plotësisht jashtë funksionit duke mos lejuar të ofrohet apo të merret informacion në lidhje me vendndodhjen e monumenteve dhe zonat e tyre të mbrojtura. Disa herë i jemi drejtuar AKSHIT për hartim specifikimesh teknike, realizimin e shërbimit sepse ky web është kaluar kalim kapital AKSHIT, por akoma sot nuk ka zgjidhje.

d) **Mungesa e punonjësve sipas strukturës organike në IKTK:**

- ✓ Nevoja për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e sektorëve teknikë, ka qenë dhe mbetet problem në IKTK.
- ✓ Një kërkesë tjetër e IKTK është edhe rritja e efikasitetit të burimeve njerëzore, duke kërkuar pranë Ministrisë së Kulturës rishikimin të strukturës së institucionit për shkak të rritjes së kërkesave dhe fushës së shtrirjes së veprimtarisë së institutit, në rang kombëtar.

8. PLANIFIKIMI PËR VITIN 2023 (OBJEKTIVAT)

8.1.Përmirësimi i kuadrit ligjor

- ✓ Të angazhohet në hartimin e projekt akteve në bazë të Planit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve (PPAP), për vitin 2023 nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës; (Të gjithë sektorët).
- ✓ Hartimi i propozimit për tarifën e shërbimeve të ofruara nga IKTK dhe paraqitja e tyre pranë Ministrisë së Kulturës, për përfshirjen në Urdhrin e Përbashkët të saj me Ministrinë e Financave; (Të gjithë sektorët)
- ✓ Hartimi i udhëzuesit për menaxhimin dhe administrimin e tarifave të shërbimit të IKTK; (Të gjithë sektorët)
- ✓ Hartimi i Strategjisë së Riskut 2023-2025 për IKTK; (Të gjithë sektorët)
- ✓ Përmirësimi i kuadrit ligjor me akte ligjore dhe nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (DMK + DSHA):
 - a) VKM për deklarimin e interesit kulturor;
 - b) VKM e re Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP);
 - c) VKM e rishikuar Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP);

- d) VKM për zonifikimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Beratit, Vlorës dhe Sarandës dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.
- e) VKM në lidhje me zonën arkeologjike nënujore të bregdetit të qytetit të Durrësit, në bashkëpunim me IA dhe QMD.
- f) VKM për zonën Arkeologjike “A” të Gradishtës së Selcës dhe zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, Kalasë së Lëkurësit dhe Manastirit të 40 Shenjtorëve.

8.2.Partneritete dhe Marrëveshje bashkëpunimi (IKTK)

- ✓ Vijimin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet IKTK dhe organizatës Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri (CHwB Albania) me Nr. 502 Prot., datë 16.03.2022, për “Përmirësimin e sistemit të monitorimit të gjendjes së pasurive kulturore për priorizimin efikas të ndërhyrjeve, si dhe vlerësimin potencial të riskut në objektet e trashëgimisë kulturore materiale”, projektit i cili parashikohet të implementohet brenda një periudhe 2-vjeçare. Përditësimi i formatit të kartelave të pasurive kulturore, me qëllim përpilimin e të dhënave të tyre në format databaze digjitale, do të nisë fillimisht me Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, si projekt pilot gjatë vitit 2023, për të vijuar më tej edhe me drejtoritë e tjera. Një projekt i cili do të shërbejë për rritjen e efikasitetit në monitorimin periodik të tyre si edhe në vlerësimin e dëmeve në raste fatkeqësish. Gjithashtu, pas digjitalizimit të formatit të kartelave, projekti përfshin trajnimin e stafit teknik të DRTK-ve mbi procesin e kartelizimit digjital të pasurive kulturore (vlerësimin i gjendjes së konservimit).
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet IKTK-së dhe Institucioneve të arsimit të lartë, si dhe organizmave që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- ✓ Studimi i atelieve të pikturimit dhe përgatitja e relacioneve për ndërhyrje restauruese në bashkëpunim dhe pjesëmarrjen e specialistëve të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), Prof. Fatos Ylli sipas marrëveshjes përkatëse.

8.3.Programe shtetërore dhe ndërkombëtare në trashëgimi kulturore

- ✓ Bashkëpunim i drejtpërdrejtë me INRAP (Institut National de Recherches Archéologiques Préventives), Francë dhe Ministrinë e Kulturës Francë për organizimin e programit/aktivitetit “DITËT EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË” në datat 16-17-18 qershor 2023, ku IKTK do të jetë në rolin e koordinatorit për Shqipërinë;(DSHA)
- ✓ Pjesëmarrje në konferencën vjetore të 24-të të EAC me temë “Menaxhimi i Trashëgimisë Arkeologjike dhe Arkeologjia e shekujve 18-20” në Bon, Gjermani. (DSHA)
- ✓ Pjesëmarrje me poster në konferencën vjetore të 29-të të EAA në Belfast me temë “Gërshetimi i rrëfimeve, Northern Ireland-DSHA).
- ✓ Konferenca 2 ditore për arkeologjinë nënujore në bashkëpunim me ICUA Zadar, UNESCO INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE – IKTK në bashkëpunim me INTERNATIONAL CENTRE FOR UNDERWATER ARCHAEOLOGY, in Zadar – (ICUA)
- ✓ Vazhdimi i punës në kuadër të bashkëpunimit me Qendrën Kombëtare për Studime Shkencore (CNRS, Centre national de la recherche scientifique, UMR 8167, Orient et Mediterranee, Paris) – Universiteti i Sorbonës-Paris IV, për projektin “Inventari i Trashëgimisë në Shqipëri, Inventari i mozaikëve në Shqipëri”, nën drejtimin e Znj. Marie-Patricia Raynaud.

- ✓ Realizimin e disa analizave shkencore jo shkatërruese, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe European Centre for Byzantine and Post byzantine Monuments, me qendër në Selanik, Greqi, bashkë me specialistë restauratorë nga European Centre for Byzantine and Post byzantine Monuments. Vijimi i hartimit të projektit : *“Punime restauruese në kishën e manastirit të Shën Kollit, Mesopotam”*(vendim Nr. 212, datë, 3.06.2022 i KKTKM).

8.4.Marrëdhënie me UNESCO-n në kuadër të mbrojtjes së Pasurive Botërore në Shqipëri dhe në kuadër të zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore

- ✓ Realizimi i draftit final të Planit për Menaxhimin e Integruar për qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë. (IKTK)
- ✓ Realizim i Workshop-it për prezantimin final të PMI Berat-Gjirokastrë.
- ✓ Raport i gjendjes së konservimit për pasurinë botërore të Rajonit të liqenit të Ohrit në bazë të vendimit të komitetit të trashëgimisë botërore
- ✓ Raport i gjendjes së konservimit për pasurinë botërore Berat-Gjirokastrë, në bazë të vendimit të trashëgimisë botërore.
- ✓ Komunikime bazuar në raportime të mundshme mbi investime dhe projekte zhvillimore të mundshme në territorin e pasurive botërore.

8.5.Aktiviteti i IKTK-së në përputhje me Planin e punës 2023

- ✓ Pasurimi i listës së pasurive kulturore nëpërmjet një procesi studimi të thelluar kërkimor-shkencor.
- ✓ Rritja e cilësisë dhe sasisë së hartimit të projekteve të restaurimit për objekte pasuri kulturore dhe ndërhyrjen konservuese në pikturën murale, ikona dhe mozaikë, në territorin e Shqipërisë.
- ✓ Mbrojtja dhe restaurimi i veprave të artit, pikturës murale, ikonave, mozaikëve etj.
- ✓ Rritja përafërsisht në masën 10% të shërbimeve arkeologjike në terren (gërmime/sondazhe, dokumentime arkeologjike, vëzhgime arkeologjike, verifikime në terren dhe gjetje rastësore), me synim përmbushjen e veprimtarisë dhe misionit, si dhe rritjen e burimeve të financimit të DSHA-IKTK.
- ✓ Ndjekja dhe zbatimi në kohë të marrëveshjeve tre palëshe për shërbime monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve si dhe mbikëqyrjes arkeologjike gjatë realizimit të sondazheve/gërmimeve arkeologjike, në përgjigje të kërkesave dhe ritmeve të zhvillimit të projekteve nga subjektet aplikues.
- ✓ Mirëmbajtja e sistemeve WebGis të IKTK
- ✓ Realizimin dhe ndjekjen e funksionimit të sistemit unik kombëtar të hedhjes së informacionit të shërbimeve arkeologjike në terren, mbështetur në teknologjinë GPS dhe GIS në bashkëpunim të ngushtë me (i)DSHA, (ii)institucionet shtetërore(iii) subjektet publike e private të specializuara në fushën e arkeologjisë, që janë përdorues e zhvillues të platformës digjitale WebGIS, duke respektuar afatet ligjore respektive të çdo shërbimi.
- ✓ Realizimin e standartizimit të të dhënave të WebGIS Monumentet dhe përgatitjen e tyre për publikimin nga ASIG.

8.6.Monitorime arkeologjike të subjekteve private të licencuar në arkeologji- 25 në total

8.7.Sekretaria Teknike e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale – KKTKM

- ✓ Përforcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore me qëllim menaxhimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Sekretaria Teknike e IKTK-së;
- ✓ Të mundësojë publikimin brenda një afati sa më të shkurtër të mundshëm të Vendimeve të KT-së, KKTKM-së, Regjistrave Publikë si dhe njoftimeve të ndryshme në faqen web të IKTK-së;

8.8.Programe për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe Kërkimi Shkencor

- ✓ Mundësia e financimit të kurseve të trajnimit / Atelieve të Restaurimit, të propozuara nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore, nëpërmjet përmirësimit të projekt propozimeve dhe rritjes së numrit të kërkesave për financim.

8.9.Botime dhe Promovime

- ✓ Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike “Monumentet” Nr.61 organ i IKTK-së, nëpërmjet rritjes së numrit të artikujve shkencor të hartuar nga stafi i IKTK-së (Për këtë vit do të hartohen 4 artikuj shkencorë nga IKTK: 1 SQHATP +1 SVA+ 1 SAAM+1 QRKREJ);
- ✓ Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike me veprimtarinë arkeologjike të Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik për vitin 2022;

8.10.“Digjitalizimi i arkivit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokollit për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence”

- ✓ Realizimin e skanimit të kartotekës së Arkivit Teknik të IKTK-së, në masën 100 %; (Arkiva Teknike)

2. MENAXHIMI I RISKUT

IKTK ka marrë masat për hartimin e Strategjisë së Riskut, drafti final i së cilës është gati për të gjithë sektorët e institucionit. IKTK ka hartuar regjistrin e identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve, i cili përmban listën e proceseve/punëve më të rrezikuara, si dhe kryhet azhurnimi në vazhdimësi.

Gjithashtu, në Regjistrin e Riskut të objekteve, IKTK kryen periodikisht azhurnimi në vazhdimësi, mbi bazën e të cilit organizohet politikat e veprimtarisë së institucionit dhe përcaktohen prioritetet për planifikimin e projekteve që do të hartohen. Lista e riskut është ndërtuar mbi bazën e të dhënave të marra nga Drejtoritë Rajonale, inspektimet e vazhdueshme të stafit të IKTK-së në objektet me status monument kulture që sipas raportimit të DRKK janë në gjendje më të rrezikuara. Sipas prioritetëve të përcaktuara nga harta e riskut, IKTK harton projektet e restaurimit, konsolidimit dhe konservimit të monumenteve dhe i bën kërkesë MK apo donatorëve të ndryshëm me të cilët bashkëpunon për financim. Harta e riskut azhurnohet në vazhdimësi me objekte, të cilave u është hartuar projekti dhe janë gati për financim apo me objektet që janë financuar realisht dhe kanë dalë nga risku. Ndërkohë harta shtohet me objekte që evidentohen si objektet të rrezikuara për arsye madhore.

a) BAZA E TË DHËNAVE DHE PËRDITËSIMI MBI PASURITË KULTURORE

Gjatë vitit 2022 IKTK-ja ka mirëmbajtur bazën e të dhënave të pasurive dhe siteve kulturore. Më poshtë të dhënat e përditësuara:

Nr.	Shpallje Monument Kulture Kategoria e I-rë dhe e II-të (Deklarim i Interesit Kulturor)	Nr. Vendimit KKTKM	Vendodhja
1.	0		
	Totali - Deklarim Pasuri Kulturore 0		

Nr.	Propozim për heqje statusi Monument Kulture Kategoria e I-rë dhe e II-të (Mungesë e Interesit Kulturor)	Nr. Vendimit KKTKM	Vendodhja
	Totali - Mungesë interesi kulturor - 1		

Nr.	Saktësim/ndryshim emërtimi	Nr. Vendimit KKTKM	Vendodhja
1	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.10 -15, dt.20.01.2022	
2	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.37-51, dt.25.02.2022	
3	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.52, dt.01.03.2022	
4	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.127-149, dt.25.02.2022	
5	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.150. dt.01.03.2022	
6	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.134-136, dt.29.04.2022	
7	Saktësim dhe ndryshim i vendimeve të KKTM	Nr.172, dt.17.05.2022	
8	Saktësim dhe ndryshim i vendimit të KKTM	Nr.331, dt.01.07.2022	
9	Miratim i kërkeses për saktësim të vendimit nr.332, dt.01.07.2022	Nr.548, dt.12.12.2022	
10	Saktësim dhe ndryshim i vendimit të KKTM	Nr.570, dt.28.12.2022	
	Totali -Saktësim/ndryshim emërtimi-10		

Shtojca 1 bashkëlidhur: Lista Zyrtare e Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore në territorin e Shqipërisë e përditësuar me të dhënat për vitin 2022.

Tabela Përmbledhëse						
Lista zyrtare e Monumenteve dhe Zonave të Trashëgimisë Kulturore 2022						
Qarku	Bashkia	Monumente Kulture kategoria I- rë	Monumente Kulture kategoria II- të	Monumente Kulture Total	Zona Mbrojtëse e Monumentit	Zonifikime të pasurive kulturore në grup
Berat	Berat	94	357	451	5	3
	Ura Vajgurore	6	-	6	2	
	Kuçovë	2	-	2	-	
	Skrapar	17	-	17	1	
	Polican	8	-	8	3	
Berat Total		127	357	484	11	3
Dibër	Dibër	18	2	20	1	
	Bulqizë	16	-	16	-	
	Mat	7	-	7	-	
	Klos	21	-	21	1	
Dibër Total		62	2	64	3	0
Durrës	Durrës	28	1	29	4	2
	Shijak	-	-	-	-	
	Krujë	29	-	29	2	2
Durrës Total		57	1	58	6	4
Elbasan	Elbasan	62	17	79	6	2
	Cërrik	5	-	5	-	-
	Belsh	3	-	3	-	-
	Peqin	7	-	7	1	-
	Gramsh	14	-	14	1	-
	Librazhd	18	-	18	-	-
	Prenjas	7	-	7	-	-
Elbasan Total		116	17	133	8	2
Fier	Fier	22	-	22	1	2
	Patos	1	-	1	1	
	Roskovec	0	-	-	-	
	Lushnje	9	-	9	2	
	Divjakë	4	-	4	-	
	Mallakastër	9	-	9	3	1
Fier Total		45	0	45	7	3
Gjirokastrë	Gjirokastrë	105	324	429	5	3
	Libohovë	20	1	21	6	-
	Tepelenë	15	6	21	7	-

	Memaliaj	2	-	2	-	-
	Përmet	26	-	26	5	2
	Këlcyrë	7	-	7	1	-
	Dropull	40	-	40	4	-
Gjirokastrë Total		215	331	546	28	5
Korçë	Korçë	78	1	79	16	2
	Maliq	18	-	18	-	-
	Pustec	9	-	9	5	-
	Kolonjë	23	-	23	4	1
	Devoll	13	-	13	1	1
	Pogradec	29	-	29	5	2
Korçë Total		170	1	171	31	6
Kukës	Kukës	10	-	10	1	-
	Has	11	-	11	-	-
	Tropojë	18	-	18	1	-
Kukës Total		39	0	39	2	0
Lezhë	Lezhë	16	1	17	4	2
	Mirditë	9	2	11	3	-
	Kurbin	5	1	6	1	-
Lezhë Total		30	4	34	8	2
Shkodër	Shkodër	117	11	128	4	5
	Malësi e Madhe	8	-	8	3	-
	Vau-Dejës	12	1	13	1	2
	Pukë	3	-	3	-	-
	Fushë-Arrëz	4	1	5	-	-
Shkodër Total		144	13	157	8	7
Tiranë	Tiranë	38	203	243	13	3
	Kamëz	-	-	-	-	-
	Vorë	2	-	2	1	-
	Kavajë	9	5	14	1	-
	Rrogozhinë	2	-	2	2	-
Tiranë Total		51	208	261	17	3
Vlorë	Vlorë	52	-	52	5	2
	Selenicë	23	2	25	3	1
	Himarë	44	-	44	8	4
	Sarandë	16	-	16	4	4
	Konispol	22	-	22	4	-
	Finiq	43	-	43	7	2
	Delvinë	20	-	20	1	-
Vlorë Total		220	2	222	32	13
TOTALI		1276	936	2214	153	46

Në zbatim të Urdhrit të titullari Nr. 36 Prot., datë 07.01.2020 është ngritur GMS dhe janë zhvilluar komunikime periodike, mbi çështjet të rëndësishme.

Sipas Urdhrit të titullarit Nr. 705 Prot., datë 06.04.2020 është krijuar njësi përgjegjëse për antikorrupsionin të cilët përgjigjen pranë autoriteteve përkatëse lidhur me kërkesat/raportet apo informacionet e ndryshme që kërkohen. Aktualisht nuk kemi pasur raste për sinjalizim të parregullsive apo të korrupsionit. Janë kryer vetë deklaratimet e punonjësve, për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, sipas ligjit të posaçëm. Mbështetur në Ligjin Nr. 9867/2005, përdoret Autorizimi përkatës për verifikimin e të dhënave, i cili nënshkruhet nga punëmarrësi dhe punëdhënësi. Ky dokument administrohet në dosjen e çdo punonjësi të IKTK-së.

Në zbatim të ligjit Nr.116/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 10 "Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit" është publikuar në faqen zyrtare të IKTKK-së "Programi i Transparencës" dhe me Urdhër Titullari Nr.93/1 Prot., datë 18.08.2021 është përcaktuar personi përgjegjës për të drejtën e informimit dhe është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve azhurnohet vazhdimisht dhe është i publikuar në faqen zyrtare ww.imk.gov.al dhe më pas ww.iktk.gov.al.

3. AKTIVITET E KONTROLLIT

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të institucionit, nëpërmjet strukturave drejtuese, deri në vendimmarrje, janë kryer veprime të cilat synojnë reduktimin e risqeve me synimin për të arritur objektivat e institucionit deri në marrjen e vendimeve.

a) Vendimet e marra.

Institucioni ynë konstaton se ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe kanë vënë në zbatim kontrole të përshtatshme në fushat e mëposhtme:

Aktivitet me vlerë ruhen nga përdorimi i paautorizuar, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në Kontratën Individuale dhe Rregulloren e Brendshme.

Në lidhje me përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme mënyra e tyre e përdorimit. Aktivitet afatgjatë dhe aktivitet e vlefshme për institucionin janë të mbrojtura kundrejt aksesit dhe përdorimit të paautorizuar.

Pranë IKTK-së kanë funksionuar rregulla/urdhëra të brendshëm për përshkrimin e proceseve kryesore operacionale dhe financiare, sistemin e firmës së dyfishtë, ruajtjen e aktiveve dhe ndarjen e detyrave, dokumentimin e të gjitha operacioneve/veprimeve dhe transaksioneve financiare si dhe procedura të tjera të miratuara, në aktivitetin kryesor deri në vendimmarrje.

Gjithë transaksionet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues dhe ato kryhen në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e Ministrisë së Financave.

Ekzistojnë kontrollet në nivel menaxherial.

Urdhër Shpenzimet aprovohen nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues konform kërkesave të legjislacionit për përdorimin e buxhetit.

Punonjësit marrin udhëzime, trajnime lidhur me mënyrën se si të sillen përballë ofertave korruptive.

Për sa i përket sistemeve financiare, sistemit të pagave, prokurimeve, kontabilitetit, kemi ndjekur dhe zbatuar legjislacionin në fushën financiare.

Gjatë vitit 2022 janë respektuar gjurmët e auditimit për menaxhimin e aktiveve dhe mbrojtjen e tyre, respektivisht janë përcaktuar qartë procedurat që duhen ndjekur që nga krijimi i aseteve në institucion, regjistrimi, dokumentimi, marrja në dorëzim, vlerësimi.

Po në kuadër të kësaj procedure, është parashikuar edhe cikli i qarkullimit të dokumentacionit të vlerave monetare, etj. Janë realizuar kontrole mujore në lidhje me arkën dhe magazinën e institucionit. Gjithashtu kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i karburantit për automjetet.

Rregullat për mirëmbajtjen në ambientet e institucionit mbështeten në nenin 6, gërma e) të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 110/2015, datë 15.10.2015, si dhe Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Për sigurinë e institucionit, janë përgjigjur personat përgjegjës (mirëmbajtësit), si dhe të gjithë punonjësit e institucionit gjatë orarit të punës. Me mbarimin e punës, punonjësit kujdesen për marrjen e masave për parandalimin e dëmtimeve fizike, mbylljen e dritareve, pajisjeve elektrike dhe elektronike. Në mjediset e institucionit nuk lejohet të flitet me zë të lartë. Bisedat telefonike nga telefoni i zyrës duhet të jenë vetëm për motive pune dhe nuk duhet të tejkalojnë limitet financiare të përcaktuara. Punonjësit e shërbimit kujdesen për mirëmbajtjen e zyrave dhe të pajisjeve. Ai bën kontrole në zyrat, ambientet e brendshme, për të patur standarde pune të qeta dhe të sigurta. Aktivët (pajisje zyre, mjete për punën, etj.) jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe gjëndjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim. Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast përfundimi të marrëdhënieve të punës ose transferimi nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga nënpunësi autorizues, sipas specifikave të aktiveve.

b) Masat e veprime

Përsa i përket sistemeve financiare, sistemit të pagave, prokurimeve, kontabilitetit, kemi ndjekur dhe zbatuar legjislacionin në fushën financiare. Në lidhje me përmirësimet e mëtejshme janë marrë masat zbatuese në përputhje me rekomandimet e lëna, nga auditimet e kryera.

4. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Komunikimi i brendshëm në IKTK, është realizuar nëpërmjet memove dhe shkresave të brendshme, të cilat rezultojnë të kenë datën e hartimit të tyre dhe në zbatim të Vendimit Nr. 4, datë 19.6.2017, për miratimin e “*Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë*” e Këshillit të Lartë të Arkivave, dhe të “*Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

a) Menaxhimi i përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve të zyrës:

Në zbatim të Urdhrit nr. 30, datë 17.01.2022 “ *Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Informacionit*”, është kryer emërtimi i të gjitha pajisjeve kompjuterike sipas formatit emër-mbiemër, portat e USB janë të bllokuara dhe Microsoft Defender for Endpoint e instaluar me sukses. Gjithashtu çdo pajisje është pjese e domain qeveritar GOV dhe çdo përdorues ka te drejta te limituara sipas pozicionit të punës. Çdo pajisje kompjuterike disponon update te fundit nga Microsoft .

Pajisjet e zyrës në përdorim të punonjësit janë përdorur vetëm për qëllime pune dhe përdorimi për nevoja personale i pajisjeve elektronike është i kufizuar, duke garantuar përparësinë e përdorimit për qëllime pune. Çdo pajisje kompjuterike që i jepet një punonjësi nga institucioni, në përfundim të përmbushjes së detyrës, i janë kthyer institucionit, duke ruajtur komunikimet zyrtare. Në çdo sistem kompjuterik janë instaluar vetëm ato programe që i nevojiten punonjësit për kryerjen e detyrës. Lista e programeve, software, ose programet e lejuara për instalim, janë të miratuar nga AKSHI.

b) Menaxhimi i Postës Elektronike:

Sistemi i postës elektronike është përdorur vetëm për qëllime pune. Se fundmi është aplikuar metoda Two-factor authentication (2FA). Është një metodë sigurie e menaxhimit të identitetit dhe aksesit që kërkon dy forma identifikimi për të aksesuar burimet dhe të dhënat. 2FA u jep përdoruesve aftësinë për të monitoruar dhe ndihmuar në mbrojtjen e informacionit dhe rrjeteve të tyre më të cenueshme. Kjo metode është aplikuar çdo mailbox të përdoruesve, dhe bën të mundur shtimin e sigurisë së postës elektronike në mënyrë për të parandaluar aktivitetet dashakeqëse. Specialisti i ngarkuar, monitoron postën elektronike dhe përdorimin e internetit dhe nuk ka të drejtë privatësie në krijimin, dërgimin apo marrjen e një e-mail për qëllime pune. Posta elektronike që dërgohet nga këto sisteme konsiderohet si çdo lloj tjetër komunikimi zyrtar. Këto mjete komunikimi në tërësinë e tyre përfaqësojnë institucionin, ndaj shkruhen sipas standardeve të gjuhës shqipe.

c) Menaxhimi i Portalit Zyrtar të Institucionit:

Plani strategjik i komunikimit, i aplikuar përgjatë vitit 2022 nga IKTK, kishte për qëllim promovimin në mediat elektronike dhe të shkruara, të gjithë punës së kryer përgjatë vitit si:

- Promovim i punës së përditshme të specialistëve në kryerjen e inspektimeve në terren, hartimi i projekteve restauruese si dhe pjesëmarrja në aktivitete kushtuar fushës së trashëgimisë kulturore.
- Promovimi i ecures së punimeve në kantieret e ngritura në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- Promovimi i eventeve të organizuara nga IKTK

d) Menaxhimi i Publikimeve:

Redaksia në bashkëpunim me stafin e Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, kanë realizuar mbledhjen e materialeve në lidhje me botimin e numrit të ri të Revistës “Monumentet” Nr.60.

5. MONITORIMI

Në institucionin tonë nuk kemi pasur Ekip të Menaxhimit të Programit “Planifikim, menaxhim administrim” dhe njësi të auditit të brendshëm. Grupi i Menaxhimit Strategjik është njehsuar me EMP.

Si nëpunës autorizues, nga strukturat e varësisë direkt marr informacione periodike, për të pasur një paraqitje dhe njohuri të përditësuar të situatës ekonomike-financiare të aktivitetit në tërësi, në përmbushje të objektivave si dhe mangësitë e vërejtura, të cilat kanë penguar realizimin e tyre.

Përgjegjësit e sektorëve kanë dhënë informacione mujore të punës së kryer dhe raportojnë çdo muaj.

Si Drejtues i programit informohem mbi shpenzimet aktuale krahasuar me buxhetin e planifikuar nga nëpunësi zbatues, i cili mbulon financat e Institucionit. Informacioni i marrë ndihmon në vendimmarrjen time.

Si Nëpunës Autorizues i Institucionit, kërkoj dhe monitoroj çdo javë, muaj, 3-muaj dhe sipas rastit, në vijimësi për aktivitetin e strukturave që drejtoj.

Monitorimi është kryer edhe nga Drejtorët e Drejtorive si dhe Përgjegjësit e Sektorëve, lidhur me realizimin e detyrave të vartësve të tyre.

Raportet e monitorimit pranë organeve monitoruese të IKTK-së janë: situacionet mujore, raportet e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, pasqyrat financiare mbi mbylljen e vitit buxhetor, statistikat 3-mujore mbi numrin dhe pagat e punonjësve, raportet e monitorimit, raportimet mbi sistemin HERMIS si dhe raportime të ndryshme të kërkuara nga MK etj.

NËPUNËS AUTORIZUES

EUGEN KALLFANI

NËPUNËS ZBATUES

AFRIDA DOMNORI